

DANEEL PRO

PRODUKT PËR MBROJTJEN E BIMËVE



GHS07 GHS08 GHS09

“Lexo fletëudhëzuesin para përdorimit”

DANEEL PRO është fungicid sistemik dhe kontakti me veprim parambrojtës dhe kurativ, në formë koncentratit të suspendueshem. Ky fungicid përdoret kundër një numri të madh sëmundjesh të kulturave bujqësore. Ka një efektivitet të shkëlqyer në kontrollin e kromave në mollë dhe dardhë (*Venturia inaequalis*, *Venturia pirina*). Në hardhi, kundra vrugut (*Plasmopara viticola*), kalbëzimit të zi (*Guignardia bidwellii*), dhe eskoriozës (*Phomopsis viticola*).

Lënda vepruese: 125 gr/lit dithianon + 561 gr/lit fosfonat kaliumi;

Formulumi: Koncentrat i suspendueshëm (SC).

Masat parambrojtëse:

Deklaratat e rrezikut

H317: Mund të shkaktojë reaksione alergjike të lëkurës.

H319: Shkakton acarim serioz të syve.

H351: Dyshohet se mund të shkaktojë kancer.

H400: Shumë toksik për gjallesat ujore.

H410: Shumë toksik për jetën ujore duke shkaktuar efekte afatgjata të dëmshme.

EUH401: Te evitohen rreziqet e shëndetit të njeriut dhe ambjentit, në përputhshmëri me instruksionet për përdorim.

Deklarata parandaluese (Parandalimi)

P101: Në rast helmimi tregojeni mjekut etiketën e produktit.

P102: Mbajeni në vende të sigurta, larg fëmijëve.

Mbajeni larg nga ushqimet dhe pijet për njerëz dhe ushqimet e kafshëve.

Evitoni kontaktet me sytë dhe lëkurën.

Gjatë përdorimit të tij mos ha e mos pi uje dhe duhan.

Merrni udhëzime të veçanta para përdorimit.

P202: Mos trajto derisa të kenë lexuar dhe kuptuar masat e sigurisë.

P261: Shmangni thithjen e pluhurit me frymëmarrje.

P264: Lahuni me ujë të bollshëm dhe sapun tërësisht pas trajtimit.

Hiqni rrobat e kontaminuara dhe lahuni pas përfundimit të punës.

P272: Përdoreni vetëm jashtë ose në zonë të ajrosur mirë.

P280: Veshni doreza mbrojtëse dhe mbrojtëse të tjera për fytyrën dhe sytë.

Udhëzime për ndihmën e parë dhe këshilla për mjekun:

Deklarata parandaluese (Reagimi)

Mund të shkaktojë reaksione alergjike të lëkurës.

P303+P352: Në rast kontakti me lëkurën (flokët): Lajeni menjëherë me ujë të bollshëm dhe sapun.

Shkakton acarim serioz të syve.

P305+P351+P338: NË RAST KONTAKTI NË SY: Shpëlani vazhdimisht për disa minuta me ujë. Hiqni lentet e kontaktit, nëse janë të pranishme dhe nëse është të lehtë për t'u bërë. Vazhdoni shpëlarjen.

Helmues në rast marrje me organet e frymëmarrjes. Në rast gjëllitje ose marrje me organet e frymëmarrjes, pacienti vendoset në një vend me ajër të pastër dhe të freskët dhe mbulohet për t'u mbajtur ngrohtë.

I aksidentuari nuk jep shenja karakteristike.

P308+P311: Nëse je ekspozuar dhe nëse je i shqetësuar, Telefononi Qendrën e helmimeve ose një mjek.

Aplikohet terapi simptomatike.

P333+P311: Në rast acarimi ose skuqe të lëkurës: Telefononi qendrën e helmimeve ose doktorin.

P337+P311: Nëse acarim sy vazhdon: Merrni ndimën e parë mjeksore ose paraqituni tek mjeku.

P362+P364: Hiqni rrobat e kontaminuara dhe lahuni pas përfundimit të punës.

P391: Mblidhni dhe pastroni rrjedhjet.

P405: Mbajeni të kyçur.

Deklarata parandaluese (Shkatërrimi)

P501: Shkatërrimi i permbajtjes/shisheve ne perputhje me rregullat në fuqi.

Përdorimi:

DANEEL PRO është fungicid sistemik dhe kontakti me veprim parambrojtës.

Në pemët frutore farore, për kontrollin e kromës së mollës (*Venturia inaequalis*), kromës së dardhës (*Venturia pirina*), me 2.5 lit/ha me sasi të ujit nga 150-1500 lit. Trajtimet për kromën e mollës dhe të dardhës nisin deri në momentin që fryhet sythi dhe vazhdon deri në fazën e pjekjes, me interval kohor 5-10 ditë. Në **Hardhi, kundra vrugut** (*Plasmopara viticola*), kalbëzimit të zi (*Guignardia bidwellii*), me 3-4 lit/ha, 4-5 trajtime/sezon me interval kohor 5-10 ditë. Për kontrollin eskorizës së hardhisë (*Phomopsis viticola*), me 3 lit/ha, 2-3 trajtime/sezon me interval kohor 5-10 ditë.

Vërejtje për përdorimin:

Kujdes kur përzihet me produkte të tjera që permbajnë karbonat dhe bikarbonat sepse keto të dy substanca ulin ndjeshëm efikasitetin e produktit. Nuk përzihet me lëngun bordolez, sulfatin e bakrit dhe me produktet e tjera alkaline. Për perzierjen me produktet të tjera duhet të keshilloheni me specialistin perkates.

Fitotoksiciteti:

Nuk është fitotoksik kur përdoret me dozat dhe në kulturat e rekomanduara.

Ndikimi në mjedis:

Nuk është helmues për bletët.

Shumë toksik për gjallesat ujore. Shumë toksik për jetën ujore duke shkaktuar efekte afatgjata të dëmshme. Mos ndotni ujrat dhe basenet ujore me produktin ose ambalazhin e tij. Mblidhni dhe pastroni rrjedhjet.

Karenca:

Në pemë frutore farore 35 ditë. Në hardhi 35-42 ditë.

Magaznimi:

Mbajeni të kyçur. Ruhet në vende të errta, të freskëta dhe në ambalazh origjinal.

Nr dhe data e regjistrimit: 665, date 6.02.2017.

Sasia neto e PMB-se, që ndodhet në ambalazhin bazë: deri 1 Lit.

Bar kodi përkatës:

Data e prodhimit:

Data e skadencës ose periudha e ruajtjes (sipas kërkesave të përcaktuara): 3 vite;

Numri i partisë së mallit (serisë) ose shenja të tjera identifikuese:...

Tipi i ambalazhit bazë: shishe PET ose COEX ose HDPE.

Emri dhe adresa e aplikantit: BASF Agro BV. **Adresa:** Zyrih Zvicër.

Emri dhe adresa e fabrikuesit të PMB-se: BASF Agro BV. **Adresa:** Zyrih Zvicër.

Distributori për Shqipërinë: AgroHelp-SA. sh.p.k, adresa: Autostrada Tiranë-Durrës km 22 Xhafzotaj, Durrës.